



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0664057089

Nr. 638/6 Prot.

Tiranë, më 29/12/2017

V E N D I M

Nr. 200 , Datë 29/ 12 /2017

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS
“PERFORMANCA E MINISTRISË SË ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË NË
ZHVILLIMIN E SPORTIT”

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas Programit të Auditimit nr. 638/1, datë 06.10.2017 realizoi auditimin e performancës me temë “Performanca e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë në zhvillimin e sportit”. Ky auditim u programua për t’u ushtruar në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 638/3 datë 25.11.2017 iu dërgua Projekt-Raporti i Auditimit Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimi priti observacionet nga subjekti nën auditim. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë përcolli vërejtjet dhe komentet me shkresën nr. 12335/1 prot., datë 29.12.2017.

Në përfundim, pasi u njoha me raportin përfundimtar të auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit, të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

KONKLUDOVA

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR) është ministria përgjegjëse për sportin në Republikën e Shqipërisë. Krahas politikave që synojnë sigurimin dhe zhvillimin e një sistemi arsimor cilësor, ajo harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, harton politikat mbrojtëse dhe promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e sportit shqiptar. Në strukturën e

Ministrisë ka patur një drejtori të veçantë, Drejtoria e Sportit, përgjegjëse për këtë fushë. Njëkohësisht, Agjencia e Shërbimit të Sportit, në varësi të MASR, ofron shërbime për federatat shqiptare të sportit, shoqatat dhe klubet sportive që kërkojnë mbështetjen e saj. Kjo agjenci asiston dhe mbështet me personel të specializuar dhe infrastrukturë, Federatat Sportive në Republikën e Shqipërisë për zhvillimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prioritetet kryesore të MASR në zhvillimin e sportit janë zbatimi i politikave shtetërore për sportin elitare në drejtimin organizativ, teknik dhe funksional të të gjitha forumeve shtetërore të sportit, legjislacioni që rregullon marrëdhëniet midis shtetit dhe institucioneve sportive, si dhe hartimi i politikave dhe promovimi i lëndës së edukimit fizik në shkolla.

MASR menaxhon buxhetin e caktuar vjetor, me qëllim krijimin e një mjedisi të shëndetshëm për komunitetin sportiv, për ushtrimin e veprimtarive individuale dhe kolektive, të veçanta apo periodike, në mënyrë që të gjitha së bashku të jenë në ndihmë të lartësimit të imazhit të vendit dhe rritjes së cilësisë së jetesës prej burimeve të aktiviteteve sportive.

MASR, një pjesë të fondeve për sportin ua akordon organizatave sportive në bazë të kriterëve të përcaktuara në aktet rregullatore. Ministria, pas paraqitjes së dokumentacionit nga ana e organizatave sportive dhe vlerësimit të tij, shpërndan grantet për secilën prej tyre.

Fondi Kombëtar për Zhvillimin e Sportit është një fond i krijuar enkas për zhvillimin e sportit, i parashikuar fillimisht në nenin 37 të Ligjit nr. 9376 datë 21.04.2005, me ndryshime të mëtejshme në vitet 2007, 2008, 2010 e 2017, por që në thelb përcaktohej si fond që sigurohej nga të ardhurat e llotarive sportive, me qëllim financimin dhe zhvillimin e sportit në vend. Neni 40 i Ligjit aktual në fuqi nr. 79/2017 “Për Sportin”, e përkufizon si një fond që sigurohet nga të ardhurat nga bastet sportive dhe lojërat e fatit. Drejtoritë që ngarkohen për shpërndarjen e këtij fondi janë Drejtoria e Sportit dhe Drejtoria e Financës në MASR.

Gjithashtu, Ministria duhet të ndjekë dhe mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit në fuqi në organizatat që lidhen direkt me cilësinë sportive (siç janë Federatat sportive). Ligji 79/2017 “Për sportin” është ai që përcakton rregullat e funksionimit dhe organizimit të sportit në Shqipëri. Rishikimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor bëhet edhe për sportin në institucionet arsimore, si dhe organizimi dhe monitorimi i projekteve me qëllim afrimin e fëmijëve dhe të rinjve me kulturën sportive për të bërë të mundur edukimin e një stili jetese të shëndetshëm e aktiv.

Në lidhje me pyetjen kryesore të këtij auditimi, *“A janë vjelë dhe shpenzuar siç duhet nga ana e MASR fondet për ushtrimin dhe zhvillimin e sportit?”*, u arrit në këtë mesazh auditimi:

“Gjendja aktuale e sportit në Shqipëri vuan mungesën e vizionit dhe joefektivitetin e politikave për zhvillimin e tij nga ana e qeverive të ndryshme dhe Ministrisë përkatëse, fondet e pakta të akorduara çdo vit në favor të tij nga Buxheti i Shtetit, si dhe joeficiencën në përdorimin e burimeve të ndryshme të fondeve për sportin.

Pushteti qendror dhe Ministria përgjegjëse i kanë dhënë sportit gjithmonë një rol dytësor në jetën e qytetarëve shqiptarë dhe sportistëve, elitare apo amatorë. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, pavarësisht përpjekjeve, ka qenë joefektive sa i përket zhvillimit të sportit, duke bërë që shumat e vogla të granteve të alokuara për federatat, të mos përmbushin misionin e tyre në promovimin dhe ushtrimin normal të disiplinave

përkatëse dhe rritjes së interesit nga ana e publikut. Institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore nuk garantojnë plotësisht kushtet për ushtrimin e aktiviteteve nga sportistët, nxënësit apo të rinjtë. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë nuk ka qenë plotësisht efiçiente në ndarjen e fondeve në dispozicion, duke mos kontribuar mjaftueshëm në përmirësimin e infrastrukturës sportive.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit nuk kanë derdhur tërësisht për llogari të Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit, të ardhurat nga kompanitë e basteve përgjatë viteve 2013-2016, duke i shkaktuar buxhetit të MASR një efekt financiar negativ, joekonomicitet dhe të ardhura të munguara prej 22,964,841 lekësh. Të ardhurat e munguara të vitit korrent, deri në muajin Korrik 2017, janë 7,976,440 lekë, shumë kjo e destinuar për zhvillimin e sportit.”

Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve:

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë *“Performanca e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë në zhvillimin e sportit”*, të ushtruar në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

Për Pyetjen: A janë respektuar kriteret e vendosura në ligj për alokimin e granteve në favor të organizatave sportive?

Detyrimi ligjor i MASR për mbështetjen e organizatave sportive kombëtare me financim është realizuar vetëm pjesërisht në raport me kërkesat e këtyre organizatave. Plotësimi i kërkesave për financim në këtë nivel ka shkaktuar vështirësi konkrete për përmbushjen e detyrave dhe objektivave që federatat shqiptare të sportit kanë në zhvillimin e aktivitetit të tyre.

Buxheti i përgjithshëm për sportin, bazuar në analizën e raportit kërkesë-nevojë, rezulton i papërshtatshëm për të garantuar zhvillimin e sportit si detyrim i shtetit, në kuadër të përcaktimit të tij si aktivitet publik, me interes të përgjithshëm për gjithë shoqërinë.

Gjetje:

- MASR nuk ka një strategji të mirëfilltë apo plan veprimi afatgjatë për zhvillimin e sportit, i cili të bazohet dhe mbështetet nga burime financimi publike apo të tjera, të mjaftueshme për realizimin e tij;
- Grantet e akorduara nga MASR për federatat përbëjnë rreth 20-40% të kërkesës së tyre vjetore të paraqitur (pika 1, Udhëzimi i Përbashkët nr. 4/2014);
- MASR nuk ka analizuar institucionalisht rezultatet e (pa)arritura nga organizatat sportive, si rezultat i financimit publik të tyre. Në organet drejtuese të federatave, asamble vjetore apo mbledhje të komiteteve drejtuese nuk rezulton një analizë konkrete e këtij aspekti të rëndësishëm, një vlerësim i përbashkët i specialistëve të MASR me drejtuesit e federatave, për të evidentuar arritjet dhe problemet e këtij bashkëpunimi (pika 3, Udhëzimi i Përbashkët nr. 4/2014);
- MASR nuk ka marrëdhënie kontrolli dhe vlerësimi me Federatën Shqiptare të Futbollit, ashtu sikurse ka me federatat e tjera (Neni 8, pika 1, Ligji nr. 79/2017 “Për sportin”);

- FSHF nuk ka zbatuar kërkesën ligjore për të njoftuar MASR për çdo vendim të saj brenda 10 ditëve nga marrja e tij dhe kjo e fundit nuk ka një mekanizëm monitorimi për të. Kjo kërkesë e ligjit të mëparshëm të sportit, që ka qenë në fuqi nga viti 2007 deri në Korrik 2017, nuk është zbatuar nga FSHF dhe nuk është evidentuar si shkelje nga ana e MASR (Neni 14, pika 4, Ligji nr. 9376/2005 “Për sportin”);
- Rreth 20-45% e fondit të akorduar federatave shkon vetëm për pagat, shpenzimet e administratës dhe kualifikimin e tyre profesional;
- Federatat sportive kanë gjeneruar shumë pak ose aspak të ardhura nga aktiviteti tyre, donacionet, sponsorët, të drejtat televizive apo çdo burim tjetër të ligjshëm;
- Klubet shumësportëshe Studenti dhe Partizani marrin fonde nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Ministrisë, njësoj sikurse federatat e tjera apo Komiteti Olimpik.

Për sa më sipër rekomandoj:

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të hartojë një dokument strategjik afatgjatë për zhvillimin e sportit në vend, ku të përcaktohen qartë objektivat sportive dhe burimet publike të financimit për realizimin e këtyre objektivave.

Brenda muajit Maj 2018

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të propozojë pranë Këshillit të Ministrave nxjerrjen e një akti nënligjor ku të përcaktojnë më qartë kriteret e alokimit të granteve për federatat, duke përcaktuar kufij minimalë për financimin e secilës prej tyre në përputhje me kërkesat e tyre.

Brenda muajit Mars 2018

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të krijojë një marrëdhënie të standardizuar bashkëpunimi me Federatat sportive shqiptare, pa shfaqur trajtime preferenciale, duke mos emëruar Sekretarët e tyre të Përgjithshëm (si e pabazuar në ligj) e duke respektuar autonominë e tyre.

Në vazhdimësi

Për Pyetjen: A ka qenë efektiv monitorimi i MASR për përdorimin e granteve nga ana e organizatave sportive?

Bazuar në të dhënat e marra nga federatat shqiptare të sportit që u analizuan, rezulton që mungesa e financimeve buxhetore ka sjellë një reduktim të mundësive që këto federata kanë për organizimin e aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare, për financimin e sportistëve elitare, trajnerëve të tyre, për mbështetjen e kërkesave për trajtim të përshtatshëm ushqimor, mjekësor e rekuperues.

Në auditim u konstatua se burimet alternative të financimit të federatave shqiptare të sportit janë pothuaj inekzistente dhe zënë një vend tejet të papërfillshëm në buxhetin e përgjithshëm të tyre. Në përgjithësi, i vetmi burim jashtë buxhetit publik të akorduar nga MASR, është kuotizacioni i klubeve anëtare, një pjesë e madhe e të cilit paguhet përsëri me fonde publike, duke qenë se klubet sportive, anëtare të federatave, janë klube në pronësi të bashkive dhe financohen nga fonde të buxhetit lokal. Ndërsa sa i përket financimit nga të drejtat televizive, shitja e biletave, reklamat, sponsorizimet e donacionet, ato janë të papërfillshme dhe zënë më pak se 5% të buxhetit të përgjithshëm të tyre. Të dhënat e marra nga federatat konfirmojnë një ulje të spektatorëve që shohin ndeshjet e kampionateve tona kombëtare. Arsyet kryesore janë

kushtet aspak të përshtatshme të ambienteve sportive dhe cilësia e rezultateve sportive të shprehura në këto aktivitete.

Gjetje të përgjithshme:

- Federatat shqiptare të sporteve kanë një sërë mangësish në personel administrativ e teknik dhe në bazë materiale;
- Federatat nuk kanë në stafin e tyre më shumë se dy punonjës (përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm);
- MASR financon me fonde buxhetore funksionimin e Klubeve Sportive Shumësportëshe Studenti dhe Partizani;
- Klubet sportive shumësportëshe nuk organizohen ende dhe të funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose për organizatat jofitimprurëse (Neni 21, pika 3 e Ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”);

Gjetje Federata e Atletikës:

- Ka patur disa raste ku FSHA nuk ka marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare të rëndësishme të organizuara nga Federata Botërore, Europiane dhe Ballkanike e Atletikës (përkatësisht IAAF, EAA, ABAF);
- FSHA, për disiplinat e pistës, aktualisht operon në 3 stadione të vendit: Korçë, Elbasan, Shkodër;
- Mungon baza materiale në disa terrene ku zhvillohen stërvitja dhe garat, si: Shtiza 500gr, 600gr dhe 800gr, gjyle 3kg, 4kg, 5kg, 6kg, 7.26kg, pedana për kërcim së gjati dhe 3-hapsh, pedana për shtytjen e gjyles, pedana për flakje çekiçi, kafaz sigurie kufizues, pengesa për garat e 100m, 110m, 400m, pengesat e mëdha për garat 2000m dhe 3000m për gropën e ujit, dyshek kërcimi për së larti, drushta dhe steka për kërcim së larti, shkop, drushta dhe steka për kërcim me shkop, shkopinj stafete, disk 1kg, 1.5kg, 1.75kg dhe 2 kg, çekiç 3kg, 4kg, 5kg, 6kg, 7.26kg, blloqe starti, si dhe tabela elektronike;
- Federata nuk ka mjekë në organikën e vet, por paguan me honorare mjekët e kontrollit mjekësor nga Agjencia e Shërbimit të Sportit;
- Drejtoria e Sportit pranë MASR ka vënë në dispozicion për FSHA programin Kids Athletics të Federatës Botërore të Atletikës me qëllim promovimin e këtij sporti tek të rinjtë; Për periudhën e viteve 2013-2016 FSHA ka licencuar gjithsej 3348 sportistë. Tarifat e licencimit janë si vijon:

a. Licencimi i Klubit	1000 lekë
b. Licencimi i Shoqatës	500 lekë
c. Licencimi i trajnerëve	300 lekë
d. Licencimi i atletëve të rritur	300 lekë
e. Licencimi i atletëve të rinj (15-16 vjeç)	150 lekë
f. Licencimi i atletëve mosha deri 14 vjeç	100 lekë
g. Licencimi i gjyqtarëve dhe i veteranëve	100 lekë
h. Licencimi i anëtarëve të KD	500 lekë

- FSHA ka një listë trajnerësh të licencuar pranë saj;
- FSHA ka mungesa në pista atletike, palestra dhe bazë materiale në stadium.

Gjetje Federata e Basketbollit:

- FSHB-së i është akorduar zakonisht si fond grant rreth ¼ e kërkesës vjetore që bën federata;
- FSHB, në disa raste, është frenuar në pjesëmarrjen në aktivitete për shkak të mungesës së fondeve.
- Ekipet e moshave nuk kanë patur mjekë apo fizioterapistë si pasojë e mungesës së fondeve në pagesën e honorareve të tyre;
- FSHB ka realizuar disa aktivitete promovuese për personat e aftë ndryshe, si dhe “Streetball” në Tiranë e qytete të tjera;

Gjetje Federata e Volejbollit:

- FSHV ka patur raste të mospjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare;
- FSHV ka patur vështirësi për organizimin e aktiviteteve kombëtare si pasojë e objekteve të pakta sportive;
- FSHV ka mungesa në bazë materiale si: rrjeta, shtylla, kulla arbitrimi, tabela elektronike të pikëve dhe topa.

Gjetje Federata Shqiptare e Mundjes:

- Numri i vogël i stafit që parashikohet për federatat (maksimumi 2 punonjës): sipas rregullave ndërkombëtare, duke qenë se federata kujdeset për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive kombëtare, duhet të ketë përfaqësues të saj në secilin nga këto aktivitete.
- Mungesa e fondeve ka penalizuar sportistët kombëtarë, duke penguar pjesëmarrjen e tyre në aktivitete evropiane.
- FSHM është gjobitur nga Federata Ndërkombëtare e Mundjes për mospjesëmarrjen në një aktivitet evropian.
- Palestrat e klubeve të mundjes janë në gjendje krejtësisht të amortizuar, duke mos plotësuar as kushtet minimale të stërvitjes.
- Mungesa e bazës materiale pengon zhvillimin normal dhe brenda standardeve të aktiviteteve sportive kombëtare. Gjithashtu, nuk ka iniciativë për të krijuar ekipe të reja apo ekipe femrash në mundje (kusht i vendosur nga Federata Ndërkombëtare).
- Tapetet e mundjes janë në gjendje të amortizuar, ndërsa mungojnë mjete të tjera si manekinë për demonstrim, litarë për ngjitje, pesha për stërvitjen e forcës.
- Ekipi kombëtar nuk ka në përbërje mjek dhe fizioterapist gjatë përfaqësimit në gara ndërkombëtare, duke rënduar gjendjen fizike të sportistëve.
- FSHM ka gjithsej 15 ekipe dhe 455 sportistë në rang kombëtar. Tarifat e licencimit variojnë:
 - Klubi Sportiv – 2000 lekë/vit
 - Trajneri – 500 lekë/vit
 - Sportisti – 200 lekë/vit
- Edhe në FSHM ka mungesa të sponsorizimeve nga ana e kompanive private.

Gjetje Klubi Shumësportësh Partizani:

- KS Partizani nuk ka patur mundësi për të marrë pjesë në Kupa Evropiane për ekipet e volejbollit të meshkujve dhe femrave, për shkak të mungesës së fondeve.
- KS Partizani ka mungesa në bazë materiale si topa basketbolli e volejbollit, rrjeta volejbollit, kosha basketbolli, pengesa etj.
- KS Partizani ka mungesa të mjekut dhe fizioterapistit në ekip, që është në kundërshtim me rregulloret teknike të federatave sportive përkatëse.
- Në ndeshjet e kampionateve kombëtare të basketbollit apo volejbollit ka patur disa herë përplasje oraresh.

Për sa më sipër rekomandoj:

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të propozojë ndryshimin e Udhëzimit të Përbashkët nr. 4, datë 11.03.2014 “Për mënyrën e përdorimit të fondit “Grant transfertë korrente e brendshme” për federatat sportive dhe Komitetin Olimpik Shqiptar”, pika 4, në pjesën ku thuhet se financimi i kontratave të punësimit bëhet vetëm për dy punonjës (përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm) dhe numri i tyre të përcaktohet në varësi të ngarkesës së punës, aktiviteteve apo arritjeve të secilës federatë.

Menjëherë

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me federatat, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave një projekt zhvillimi afatmesëm për rikonstruktimin e objekteve sportive ekzistuese, sipas standardeve më të mira, dhe krijimin e atyre të reja. Kjo do të lehtësonte gradualisht zhvillimin e aktiviteteve sportive të federatave, do të çonte në rritjen e ndjekjes së tyre nga ana e publikut dhe përmirësimin e sportit përkatës.

Brenda muajit Mars 2018

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme me pushtetin vendor sa i përket alokimit të fondeve për klubet shumësportëshe Partizani dhe Studenti. Kjo do të vinte në jetë një standard të vetëm, sikurse ndodh me klubet e tjera që financohen nga bashkitë përkatëse, dhe MASR do të alokonte fonde për federatat dhe Komitetin.

Menjëherë

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të marrë të gjitha masat e nevojshme që klubet sportive shumësportëshe Partizani dhe Studenti të shndërrohen në shoqëri tregtare sipas kërkesave të nenit 21 të Ligjit 79/2017 “Për sportin”.

Menjëherë

Për Pyetjen: A është vjelë në tërësinë e tij Fondi Kombëtar për Zhvillimin e Sportit?

Neni 40 i Ligjit aktual nr. 79/2017 “Për Sportin”, e përkufizon Fondin Kombëtar për Zhvillimin e Sportit si një fond që sigurohet nga të ardhurat nga bastet sportive dhe lojërat e fatit. Autoriteti tatimor që ka tagër mbledhjen e të ardhurave në Republikën e Shqipërisë është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Sa i përket Autoritetit të Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit, ai është institucioni përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në ushtrimin e veprimtarisë së organizatorëve të lojërave të fatit. Të dyja këto

institucione në varësi të MFE janë përgjegjëse për mosmbledhjen e të ardhurave nga kompanitë e lojërave të fatit, të destinuara në buxhetin e MASR. Nga ana tjetër, MASR nuk ka njoftuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për mosderdhjen e plotë në llogari të saj të shumave objekt të FKZHS.

Gjetje:

- Për vitet **2013** dhe **2014** kompanitë e basteve **nuk kanë derdhur asnjë shumë** për llogari të Fondit për zhvillimin e sportit.
- Për vitin **2013** të ardhurat e pavjela nga kompanitë e basteve për FKZHS pranë MAS-it kanë qenë **4,336,008 lekë**.
- Për vitin **2014** të ardhurat e pavjela nga kompanitë e basteve për FKZHS pranë MAS-it kanë qenë **6,889,076 lekë**.
- Për vitin **2015** kompanitë e basteve kanë derdhur lekë në llogari të Ministrisë përgjegjëse për FKZHS një tepricë prej **925,350 lekësh**.
- Për vitin **2016** të ardhurat e pavjela për FKZHS kanë qenë **12,665,107 lekë**.
- Totali i të ardhurave të pavjela për Fondin e sportit për vitet 2013-2016 është **22,964,841 lekë**.
- Për vitin **2017**, deri në muajin Korrik, detyrimi i pavjelë i kompanive të basteve është **7,976,440 lekë**.
- Drejtorja e Sportit dhe Drejtorja e Financës në MASR nuk i kanë vënë në dispozicion grupit të auditimit asnjë dokumentacion ku provohet se kanë alertuar AMLF-në për detyrimet e munguara të kompanive të basteve.
- Drejtorja e Financës në MASR nuk ka zbatuar me përpikmëri detyrat e veta sa i përket kontrollimit të të ardhurave të FZHKS.

Për sa më sipër rekomandoj:

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të rakordojë me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit **shumën e prej 22,964,841 lekësh për vitet 2013-2016 dhe atë prej 7,976,440 lekësh për vitin korrent**, me qëllim vjeljen e këtyre të ardhurave të munguara nga kompanitë e licencuara të basteve.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2018

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nëpërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, të auditojë Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe të evidentojë personat përgjegjës, të cilët kishin për detyrë të garantonin vjeljen e plotë të FZHKS dhe mbikëqyrjen e këtij procesi, duke marrë masa disiplinore ndaj tyre.

Menjëherë

- Sektori i Politikave të Sportit pranë MASR, i krijuar rishtazi, të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit çdo muaj që konstaton se të ardhurat nga kompanitë e basteve nuk janë vjelë sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të kërkojë përmbushjen e të gjitha detyrimeve.

Menjëherë dhe periodikisht

Për Pyetjen: A ofron infrastruktura sportive aktuale mundësi të përshtatshme për ushtrimin e sporteve?

Miratimi i ligjit të ri të sportit, ka krijuar kushtet juridike dhe organizative për të intensifikuar dhe institucionalizuar sportin në shkolla dhe universitete, si një aktivitet i konceptuar brenda dhe jashtë kurrikulës së arsimit të ulët, të mesëm dhe të lartë.

Në këtë kontekst, koha e kaluar që nga ky miratim është e pamjaftueshme për të vlerësuar impaktin që këto rregullime ligjore do të kenë në një fushë shumë të ndjeshme të aktivitetit sportiv kombëtar. Sidoqoftë, këto rregullime ligjore mund të shërbejnë si një fillim pozitiv, duke vazhduar më pas me financimin e aktivitetit të këtyre federatave dhe krijimin e marrëdhënieve institucionale të tyre me infrastrukturën sportive të Sistemit Arsimor Kombëtar. Si arritje e rëndësishme në këtë sistem, mund të konsiderohet rritja e orëve të lëndës së edukimit fizik në shkolla, nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë, në tre orë edukim fizik në javë.

Gjetje:

- MASR nuk ka kryer një studim të mirëfilltë për nevojat për burime njerëzore dhe infrastrukturë sportive të rritjes së orëve të edukimit fizik në shkolla.
- Nga pyetësorët e shkollave të marra në shqyrtim rezulton se vetëm 24% e tyre ishin të kënaqur me gjendjen e terreneve sportive dhe palestrave.
- 62 % e shkollave të marra në shqyrtim mendojnë se investimet për rikonstruksione të terreneve sportive kanë qenë të pamjaftueshme.
- Në disa shkolla në Tiranë terrenet janë të dëmtuara, p.sh. koshat e basketbollit të thyer, rrjeta e volejbollit e këputur.
- Në rastet kur ka reshje shiu, nxënësit detyrohen të grumbullohen tek palestra e shkollës, gjë që e bën shumë të vështirë zhvillimin e një ore normale të edukimit fizik.
- Vetëm 14% e shkollave të marra në shqyrtim mendojnë se Ministria përgjegjëse për sportin ka investuar mjaftueshëm për sportin në shkolla.

Për sa më sipër rekomandoj:

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të marrë nga Drejtoritë Arsimore Rajonale përkatëse të dhëna mbi gjendjen aktuale të terreneve sportive, të brendshme e të jashtme, të bazës materiale dhe të problematikave në lidhje me aktivitetin fizik e sportiv në shkolla, për ta integruar si informacion në projektet e saj për zhvillimin e sportit në Shqipëri dhe të informojë organet përgjegjëse.

Brenda muajit Shkurt 2018

Për Pyetjen: A ka kontribuar Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit në përmirësimin e këtyre mundësive?

Shuma e mbledhur nga Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit ka qenë e ulët, duke u përdorur kryesisht për shpërblime sportistësh dhe jo për zhvillimin e sportit dhe aktiviteteve sportive. Duke marrë parasysh faktin që zhvillimi i sportit është një veprimtari që kërkon shpenzime të shumta dhe stimulim nga ana e shtetit, atëherë çdo shumë që shkon në favor të sportit ndihmon për të bërë hapa përpara.

Gjetje:

- Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit nuk është përdorur efektivisht për financimin e aktiviteteve të pambuluara nga buxheti i federatave, për shkak se të ardhurat e tij nuk janë vjelë plotësisht (Neni 40, Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin”).
- Vjelja e FKZHS ka filluar të bëhet vetëm në vitin 2015, pavarësisht se fondi ka qenë i parashikuar që në ligjin e mëparshëm për sportin.
- Gjatë viteve 2013 – 2016, **nuk është vjelë/transferuar 63% e fondit**, shumë që mund të përdorej në dobi të sportit apo infrastrukturës sportive.
- Federatat e marra në shqyrtim nuk kanë kontrata sponsorizimi me sponsorët.
- Nuk ka asnjë vendim të ri të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen dhe përdorimin e FKZHS (Neni 40, Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin”).

Për sa më sipër rekomandoj:

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me aktorë të tjerë të përfshirë në çështjen e sponsorizimeve, si federatat apo MFE, të kryejë një analizë ekonomike me qëllim përcaktimin e një formule të re sponsorizimi dhe krijimin e lehtësirave fiskale për kompanitë sponsorizuese në fushën e sportit.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2018

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të kërkojë pranë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit ndryshimin e ligjit të sponsorizimit, për të kthyer interesin e kompanive private për sponsorizimin e sporteve të ndryshme.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2018

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të nxisë Këshillin e Ministrave për të hartuar një vendim, me qëllim përcaktimin e kriterëve të shpërndarjes dhe përdorimit të Fondit Kombëtar të Zhvillimit të Sportit.

Brenda muajit Shkurt 2018

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

Sbënim: Pavarësisht punës dhe përpjekjeve të Grupit të auditimit dhe Ekspertëve të jashtëm, në vlerësimin e Kryetarit dhe Drejtorit të Departamentit, ky auditim nuk i plotësoi pritshmëritë. Problemet e sportit shqiptar, veçanërisht trajtimi i sportistëve elitare, strategjia për masivizimin e sporteve dhe përfshirja e brezit të ri në to, do të trajtohen plotësisht në auditime të veçanta përgjatë vitit 2018 dhe 2019.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R